



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.legjislacioni.gov.al

Nr. 43

Datë 3 prill 2014

P Ë R M B A J T J A

| | | Faqe |
|---------------------------------------|--|------|
| Vendim i KM nr. 182, datë 2.4.2014 | Për shfuqizimin e vendimit nr.725, datë 23.12.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për regjimin e tranzitimit të duhaneve dhe cigareve” | 1049 |
| Vendim i KM nr. 185, datë 2.4.2014 | Për përcaktimin e mënyrës së realizimit të kontrollit mjekësor bazë për shtetasit e moshës 40-65 vjeç..... | 1049 |
| Vendim i KM nr. 186, datë 2.4.2014 | Për miratimin e simbolit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit... | 1050 |
| Vendim i KM nr. 187, datë 2.4.2014 | Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.873, datë 27.12.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programeve të praktikave profesionale për punëkërkuessit e papunë që kanë mbaruar arsimin e lartë, brenda apo jashtë vendit” | 1050 |
| Vendim i KM nr. 188, datë 2.4.2014 | Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.199, datë 11.1.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programit të nxitjes së punësimit të punëkërkuessve të papunë që hyjnë për herë të parë në punë” | 1051 |
| Vendim i KM nr. 189, datë 2.4.2014 | Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.27, datë 11.1.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për programin e nxitjes së punësimit të femrave nga grupet e veçanta”..... | 1051 |
| Vendim i KM nr. 191, datë 2.4.2014 | Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.804, datë 21.11.2007, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së personelit të Policisë së Shtetit”, të ndryshuar..... | 1052 |

VENDIM**Nr. 182, datë 2.4.2014****PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR.725, DATË 23.12.2000, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR REGJIMIN E TRANZITIMIT TË DUHANEVE DHE CIGAREVE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shfuqizimin e vendimit nr.725, datë 23.12.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për regjimin e tranzitimit të duhaneve dhe cigareve".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM**Nr. 185, datë 2.4.2014****PËR PËRCAKTIMIN E MËNYRËS SË REALIZIMIT TË KONTROLLIT MJEKËSOR BAZË PËR SHTETASIT E MOSHËS 40-65 VJEÇ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 12 të ligjit nr.10383, datë 24.2.2011, "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kontrolli mjekësor bazë është një program kombëtar që synon depistimin e popullatës për faktorët e rrezikut dhe sëmundjet prevalente me qëllim kujdesin për shëndetin, parandalimin e sëmundjeve dhe komplikacioneve, zbulimin e hershëm të çrregullimeve, mjekimin në fazat e hershme dhe përmirësimin e kulturës shëndetësore.

2. Të gjithë shtetasit e grupmoshës 40-65 vjeç me qëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, përfitojnë pa pagesë nga programi kombëtar i kontrollit mjekësor bazë. Identifikimi i shtetasve të grupmoshës 40-65 vjeç me qëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë realizohet nga të dhënat e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të regjistrit elektronik, që administrohet nga mjekët e përgjithshëm të qendrave shëndetësore.

3. Paketa e kontrollit mjekësor bazë përfshin këta komponentë:

a) Vlerësim, këshillim, trajtim dhe ndjekje për faktorët e stilit të jetesës:

i) Puna që kryen apo ka kryer;

ii) Ushqyerja;

iii) Konsumimi i duhanit;

iv) Konsumimi i alkoolit;

v) Niveli i stresit dhe depresionit.

b) Matje, vlerësim, këshillim, referim dhe ndjekje e parametrave fiziologjikë:

i) Tensioni arterial;

ii) Pesha trupore;

iii) Aktiviteti i zemrës.

c) Matje, vlerësim, këshillim, trajtim, referim dhe ndjekje e parametrave biokimikë:

i) Formula e gjakut;

ii) Hb, HCT, MCV, MCH, MCHC;

iii) Kolesterol total, HDL kolesterol, LDL kolesterol, trigliceride;

iv) Glicemia;

v) Feçe për gjak okult;

vi) Albuminuria, prania e qelizave, cilindrave, kristaleve në urinë;

vii) Bilirubinë totale dhe direkte, transaminaza (SGPT, SGOT).

4. Ministria e Shëndetësisë harton protokollin e realizimit të çdo komponenti të paketës së kontrollit mjekësor bazë dhe udhëzuesin e kriterëve e të lëvizjes së shtetasve në sistemin shëndetësor për përfitimin e këtij kontrolli.

5. Ministria e Shëndetësisë miraton institucionet shëndetësore ku do të realizohen pjesë të ndryshme të paketës së kontrollit mjekësor bazë, duke garantuar mbulesën e plotë të grupmoshës së përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, bazuar në popullsinë e zonës së mbulimit, distancat e infrastrukturën, si dhe disponueshmërinë e shpërndarjen e personelit mjekësor e atij mbështetës.

6. Mjeku i familjes/qendra shëndetësore pranë të cilit janë regjistruar shtetasit që përfitojnë të drejtën për kontroll mjekësor bazë sipas këtij vendimi, njofton shtetasit për kryerjen e këtij kontrolli periodik vjetor, sipas një grafiku të bazuar në muajin e lindjes.

7. Fondi i Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor lidh kontratën për financimin e shërbimit të kontrollit mjekësor bazë me operatorë të përzgjedhur sipas dispozitave të ligjit nr.125/2013, "Për koncensionet dhe partneritetin publik privat". Kontrata duhet të rregullojë e të përcaktojë, në mënyrë të hollësishme, formën e dhënies së këtij shërbimi dhe mënyrën e pagesës së tij.

8. Informacioni i gjeneruar nga programi i kontrollit mjekësor bazë, bazuar në formularin përkatës, i cili miratohet me urdhër të ministrit të Shëndetësisë, përbën Regjistrin Kombëtar të Kontrollit Mjekësor Bazë, të vendosur në Institutin e Shëndetit Publik. Mënyra e grumbullimit, përpunimit, analizës dhe diseminimit, si dhe aksesit në të dhënat e Regjistrit të Kontrollit

Mjekësor Bazë përcaktohen me udhëzim të ministrit të Shëndetësisë.

9. Programi i kontrollit mjekësor bazë fillon të zbatohet brenda vitit 2014.

10. Ministria e Shëndetësisë përcakton mesazhin, mjetet e identifikimit, planin, kanalet e komunikimit, shtrirjen dhe kohëzgjatjen e fushatës së informimit dhe komunikimit për pjesëmarrjen e popullatës në programin e kontrollit mjekësor bazë.

11. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Fondin e Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor.

12. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Fondi i Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 186, datë 2.4.2014

PËR MIRATIMIN E SIMBOLIT TË SHËRBIMIT
KOMBËTAR TË PUNËSIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr.7995, datë 20.9.1995, “Për nxitjen e punësimit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e simbolit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, sipas konfiguracionit të aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vendimi nr.118, datë 4.4.2002, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e simbolit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

ANEKSI 1

VENDIM
Nr. 187, datë 2.4.2014

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË
VENDIMIN NR.873, DATË 27.12.2006, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MASËN E
FINANCIMIT, KRITERET DHE PROCEDURAT E
ZBATIMIT TË PROGRAMEVE TË PRAKTIKAVE
PROFESIONALE PËR PUNËKËRKUESIT E
PAPUNË QË KANË MBARUAR ARSIMIN E
LARTË, BRENDA APO JASHTË VENDIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 8 të ligjit nr.7995, datë 20.9.1995, “Për nxitjen e punësimit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.873, datë 27.12.2006, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Kudo në vendim, emërtimet “Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta” dhe “Ministria e Arsimit dhe Shkencës” zëvendësohen përkatësisht me “Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë” dhe “Ministria e Arsimit dhe Sportit”.

2. Në pikën 1 shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:
“Zyra përkatëse e punësimit bën njoftimin në Buletinin e Njoftimeve Publike, çdo vit, për fondin e vënë në dispozicion dhe kriteret e përfitimit nga ky program. Publikimi i programit bëhet gjithashtu me të gjitha mjetet e mundshme elektronike dhe joelektronike.”.

3. Në pikën 2, fjala “... listat ...” zëvendësohet me “... numrin ...”.

4. Në pikën 6 hiqen fjalët “... në raport me personelin e administratës, sipas skemës: për çdo 50 veta personel 1 praktikant ...”.

5. Pikat 7 dhe 8 ndryshohen, si më poshtë vijon:
“7. Punëdhënësit mund të aplikojnë për programin në mënyrë elektronike apo pranë zyrave të punësimit.

8. Punëdhënësi lëshon një vlerësim pune për periudhën e praktikës profesionale dhe njofton zyrën e punësimit për përfundimin e programit.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



VENDIM
Nr. 188, datë 2.4.2014

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË
VENDIMIN NR.199, DATË 11.1.2012, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MASËN E
FINANCIMIT, KRITERET DHE PROCEDURAT E
ZBATIMIT TË PROGRAMIT TË NXITJES SË
PUNËSIMIT TË PUNËKËRKUESVE TË PAPUNË
QË HYJNË PËR HERË TË PARË NË PUNË"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4 dhe 8 të ligjit nr.7995, datë 20.9.1995, "Për nxitjen e punësimit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.199, datë 11.1.2012, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në titullin e vendimit, fjalët "... që hyjnë për herë të parë në punë ..." zëvendësohen me "... të rinj ...".

2. Kudo në vendim, emërtimet "Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta" dhe "Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës" zëvendësohen përkatësisht me "Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë..." dhe "Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes".

3. Pika 1 riformulohet, si më poshtë vijon:

"1. Përfitues të këtij programi janë punëkërkues të rinj nga mosha 16-30 vjeç. Zyra përkatëse e punësimit financon:

a) punëdhënësin, me një financim mujor në masën deri në 100 për qind të kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore (pjesë e kontributit të punëdhënësit), me kusht që kohëzgjatja e kontratës së punës të mos jetë më e shkurtër se një vit. Ky financim bëhet nga zyra e punësimit në drejtorinë rajonale të sigurimeve shoqërore, sipas procedurave përkatëse;

b) punëmarrësin e përfshirë sipas këtij programi, me katër paga në masën 100 për qind të pagës minimale në shkallë vendi, në muajt e pestë e të gjashtë dhe në muajt e njëmbëdhjetë e të dymbëdhjetë të kontratës, ndërsa për muajt e tjerë financon punëdhënësi.

Punëdhënësit, persona juridikë apo fizikë, kanë të drejtë të kërkojnë të përfshijnë në program:

i) deri në 100 për qind të numrit aktual mesatar të të siguarve në tre muajt e fundit, në rast se kanë deri në 50 punonjës;

ii) deri në 50 për qind të numrit aktual mesatar të të siguarve në tre muajt e fundit, në rast se kanë mbi 50 punonjës."

4. Në fund të pikës 2 shtohet fjalia, me këtë përmbajtje

"Publikimi i programit bëhet, gjithashtu, me të gjitha mjetet e mundshme elektronike dhe joelektronike."

5. Në pikën 3 hiqen fjalët "... verifikuar nga Inspektorati i Punës ...".

6. Në pikën 4 bëhen këto shtesa:

a) Në përmbajtjen e shkronjave "a" dhe "d" pas fjalës "... juridik ..." shtohen "... dhe fizik ...".

b) Në fund të nënndarjes "v", të shkronjës "dh" shtohet nënndarja "vi", me këtë përmbajtje:

"vi. akte të inspektimit në punë, të kryera nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore."

7. Pika 6 riformulohet, si më poshtë vijon:

"6. Punëdhënësit mund të aplikojnë për programin në mënyrë elektronike apo pranë zyrave të punësimit."

8. Në pikën 10, pas fjalës "... organizimit ..." shtohen fjalët "... vlerësimit të projekteve ...".

9. Pika 11 riformulohet, si më poshtë vijon:

"11. Komisionet e miratimit të projekteve në zyrën rajonale të punësimit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit vendosin miratimin ose jo të projektit brenda 10 (dhjetë) ditëve pune."

10. Në pikën 17 hiqen fjalët "... në bashkëpunim me inspektoratin rajonal/vendor të punës ...".

11. Në pikën 18, pas fjalës "... punëdhënësi ..." hiqen "... dhe vlerësimit të Inspektoratit të Punës për shkaqet e zgjidhjes së kontratës ...".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 189, datë 2.4.2014

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË
VENDIMIN NR.27, DATË 11.1.2012, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR
PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT TË
FEMRAVE NGA GRUPET E VEÇANTA"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 8 të ligjit nr.7995, datë 20.9.1995, "Për nxitjen e punësimit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.27, datë 11.1.2012, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Kudo në vendim, emërtimi "Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta..." zëvendësohet me "Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë..." dhe emërtimi "Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës" zëvendësohet me "Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes".

2. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Përfitues të këtij programi janë femrat punëkërkuese nga grupet e veçanta, të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi. Zyra përkatëse e punësimit financon:

a) punëdhënësin, me një financim mujor në masën deri në 100 për qind të kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore (pjesë e kontributit të punëdhënësit), me kusht që kohëzgjatja e kontratës së punës të mos jetë më e shkurtër se një vit. Ky financim bëhet nga zyra e punësimit në drejtorinë rajonale të sigurimeve shoqërore, sipas procedurave përkatëse;

b) punëmarrësin e përfshirë sipas këtij programi, deri në katër paga, në masën 100 për qind të pagës minimale në shkallë vendi, në muajt e pestë e të gjashtë dhe në muajt e njëmbëdhjetë e të dymbëdhjetë të kontratës, ndërsa për muajt e tjerë financon punëdhënësi.

Punëdhënësit, persona juridikë apo fizikë, kanë të drejtë të kërkojnë të përfshijnë në program:

i) deri në 100 për qind të numrit aktual mesatar të të siguruarve në tre muajt e fundit, në rast se kanë deri në 50 punonjës;

ii) deri në 50 për qind të numrit aktual mesatar të të siguruarve në tre muajt e fundit, në rast se kanë mbi 50 punonjës.”.

3. Në pikën 3 hiqen fjalët “... verifikuar nga Inspektorati i Punës ...”.

4. Në fund të pikës 4 shtohet fjalia, me këtë përmbajtje: “Publikimi i programit bëhet, gjithashtu, me të gjitha mjetet e mundshme elektronike dhe joelektronike.”.

5. Në pikën 5 bëhen këto ndryshime:

a) Në shkronjat “a” dhe “d” pas fjalës “ ... juridik ...” shtohen “...dhe fizik...”.

b) Pas nënndarjes “v” të shkronjës “dh” shtohet nënndarja “vi”, me këtë përmbajtje:

“vi. akte të inspektimit në punë, të kryera nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.”.

6. Pika 7 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“7. Punëdhënësit mund të aplikojnë për programin në mënyrë elektronike apo pranë zyrave të punësimit.”.

7. Në pikën 10, pas fjalës “.... organizimit ...” shtohen “..., vlerësimit të projekteve...”.

8. Në paragrafin e dytë të pikës 15 hiqen fjalët “... në bashkëpunim me inspektoriatin rajonal/vendor të punës...”.

9. Në fund të pikës 16 hiqen fjalët “... dhe vlerësimit të Inspektoratit Shtetëror të Punës për shkaqet e zgjidhjes së kontratës ...”.

10. Pika 11 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“11. Komisionet e miratimit të projekteve në zyrën rajonale të punësimit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit vendosin miratimin ose jo të projektit brenda 10 (dhjetë) ditëve pune.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 191, datë 2.4.2014

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË
VENDIMIN NR.804, DATË 21.11.2007, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES SË PERSONELIT
TË POLICISË SË SHTETIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 49 e 52 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007, “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në rregulloren e Policisë së Shtetit, miratuar me vendimin nr.804, datë 21.11.2007, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në nenin 14, bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

a) Pikat 2 dhe 3 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“2. Rezultatet e testit me shkrim shpallen brenda të njëjtës ditë, kur zhvillohet testimi. Aplikantët që kanë marrë 50% të pikëve të përcaktuara për testin me shkrim njoftohen për të vazhduar procesin e testimit. Rezultatet e testit me shkrim ruhen në dosjen e aplikantit dhe përbëjnë 50% të rezultatit të përgjithshëm të tij.

3. Aplikantët që nuk arrijnë 50% të pikëve të nevojshme të testit me shkrim kanë të drejtë të riaplikojnë për t’u pranuar në Polici me shpalljen e radhës së vendeve të lira.”.

b) Pas pikës 3 shtohet pika 4, me këtë përmbajtje:

“4. Nëse për aplikantët që u përkasin minoriteteve, nga pikët e grumbulluara në testimin me shkrim nuk arrihet kuota prej minimalisht 2%, sipas nenit 19, do të njoftohen për të vazhduar procesin e testimit kandidatët e tjerë, sipas rendit zbritës, pavarësisht pikëve të testimit me shkrim.”.

2. Pas pikës 4 të nenit 19 shtohet pika 5, me këtë përmbajtje:

“5. Minimalisht 2 % e kandidatëve që pranohen në Polici të jenë nga minoritetet. Kur në listën respektive nuk ka kandidatë të mjaftueshëm për të plotësuar këtë kuotë, deri në plotësimin e saj kandidatët do të pranohen bazuar në listën e rezultateve të arritura sipas rendit zbritës, pavarësisht rezultatit të përgjithshëm të aplikantit.”.

3. Ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë)

| | |
|--|------------------|
| | Formati: 61x86/8 |
|--|------------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 8 lekë

Adresa: bulevardi "Gjergj Fishta", pas ish-ekspozitës "Shqipëria Sot",
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006